Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
*Qeveria –Vlada – Government*
*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë –Ministarstva Obrazovanja Nauke i Tehnologije Ministry of Education Science &Technology*

Kabineti i Ministrit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister

**UDHËZIM ADMINISTRATIV: Nr. 14/2013 VLERËSIMI I PERFORMANCËS SË MËSIMDHËNËSVE**

**ADMINISTRATIVNA UREDBA Br. 14/2013 VREDNOVANJE PERFORMANSE NASTAVNIKA**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION: No. 14/2013 TEACHER PERFORMANCE EVALUATION**

Në mbështetje të nenit 33 paragrafi 1 dhe 49 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-32 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 4 të Ligjit nr. 2004/37 për Inspekcionin e Arsimit në Kosovë, në pajtim me nenin 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt. 22.03.2011) dhe nenin 38 (6) të Rregullores së punës së Qeverisë nr. 09/2011, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë nxjerr:

## UDHËZIM ADMINISTRATIV

### Vlerësimi i performancës së mësimdhënësve

**Numër:** 14/2013
**Date:** 17.05.2013

### Neni 1
### Qëllimi

**1.** Ky Udhëzim administrativ (më tutje UA) ka për qëllim elaborimin e sistemit të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në Kosovë.

**2.** Vlerësimi i performancës së

Na osnovu člana 33 stav 1 i člana 49 stav 1 Zakona br. 04/Z-032 za preduniverzitetsko obrazovanje Rebulike Kosova, član 4 Zakona br. 2004/37 za Inspekciju obrazovanja na Kosovu u skladu sa članom 8 stav 1.4 Pravilnika br. 02/2011 za oblasti administrativne odgovornosti Kancelarije Premijera i ministarstva (dat. 22.03.2011) i člana 38 (6) Pravilnika rada Vlade br. 09/2011, Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije donosi ovu:

## ADMINISTRATIVNU UREDBU

### Vrednovanje performanse nastavnika

**Broj:**
**Datum:**

### Član 1
### Cilj

**1.** Ova administrativna uredba (dalje UA) ima za cilj elaboriranje sistema vrednovanje performanse nastavnika na Kosovu.

**2.** Vrednovanje performanse nastavnika realizovana prema odredbama ove AU se

Pursuant to article 33 paragraph 1 and 49 paragraph 1 of the Law no. 04/L-32 for pre-university education in the Republic of Kosova, article 4 of Law no. 2004/37 for Education inspection in Kosova, in accordance with article 8 paragraph 1.4 of the Regulation no. 02/2011 for fields of administrative responsibility of Prime Minister's Office and Ministries (dt. 22.03.2011) and article 38 (6) of the Government's Rule of Procedure no. 09/2011, Ministry of Education, Science and Technology, issues:

## ADMINISTRATIVE INSTRUCTION

### Teacher Performance Evaluation

**Number:**
**Date:**

### Article 1
### Purpose

**1.** This Administrative Instruction (further AI) aims to elaborate teacher performance evaluation system in Kosovo.

**2.** Teacher performance evaluation is implemented based on provisions of this

| | | |
|---|---|---|
| mësimdhënësve i realizuar sipas dispozitave të këtij UA, zbatohet në procesin e licencimit të mësimdhënësve që rregullohet me UA të veçantë. | primenjuje u procesu licenciranje nastavnika koja se reguliše posebnom AU. | AI and it applies to teacher licensing process which is regulated with a special AI. |
| **Neni 2**<br>**Definicionet** | **Član 2**<br>**Definicije** | **Article 2**<br>**Definitions** |
| **1.** "Hospitim" – është vëzhgimi që bëhet në orë mësimore për të pasqyruar realitetin në klasë dhe identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim të mëtejmë.<br>**2.** "Licenca " – leja e punës e lëshuar në bazë të standardeve dhe normave të miratuara paraprakisht për punëtorët e arsimit.<br>**3.** "Formulari për vlerësim" – instrumenti që përdoret për vlerësimin e punës së mësimdhënësve nga drejtori i shkollës.<br>**4.** "Formulari i planifikimit dhe zbatimit të tërësisë mësimore" – është formulari që udhëzon mësimdhënësit si të dëshmojnë aktivitetet dhe shkathtësitë e tyre planifikuese dhe realizuese në klasë.<br>**5.** "Protokolli për vëzhgim" – instrumenti që përdoret gjatë hospitimit në klasë.<br>**6.** "Performanca"– Tërësia e punës së mësimdhënësve e demonstruar përmes aktiviteteve dhe dokumentacionit përkatës. | **1.** "Poseta" – je posmatranje koja se vrši na nastavnom času sagledavanje realnost u razred i identifikovanje oblasti koje imaju potrebu za dalje poboljšanje.<br>**2.** "Licenca" – dozvola rada izdata na osnovu prethodno usvojenih standarda i normi za radnike obrazovanja.<br>**3.** "Formular za vrednovanje" – instrument koji se upotrebljava za vrednovanje rada nastavnika od strane školskog direktora.<br>**4.** "Formular planiranja i primene nastavne celovitosti" – je formular koji upućuje nastavnike kako da dokažu njihove aktivnosti i veštine planiranja i realizovanja u razred.<br>**5.** "Protokol o posmatranju" – instrument koji se upotrebljava u toku posete u razred.<br>**6.** "Performansa" – Celovitost rada nastavnika dokazana putem aktivnosti i dotične dokumentacije. | **1.** "Observation" – is observation that is conducted in a class to reflect classroom reality and to identify areas that need further improvement.<br>**2.** "Licence" – is a work permit issued based on standards and norms approved in advance for education employees.<br>**3.** Evaluation form – is an instrument that is used for evaluating teachers' performance by the school director.<br>**4.** Entire lesson unit planning and implementation form– is the form that guides teachers how to demonstrate activities and their planning and classroom implementation skills.<br>**5.** Observation protocol– Instrument that is used during classroom observation.<br>**6.** Performance – The entire work of teachers demonstrated through activities and respective documentation. |

| Neni 3 | Član 3 | Article 3 |
|---|---|---|
| **Standardet e performancës**<br>1. Standardet e vlerësimit të performancës të cilat në dokumentet përkatëse zbërthehen në kompetenca dhe indikatorë janë:<br>**1.1.** Përkushtimi ndaj nxënësve dhe mësimit të tyre;<br>**1.2.** Njohuritë profesionale;<br>**1.3.** Mësimdhënia;<br>**1.4.** Bashkëpunimi me kolegë, me prindër dhe me komunitetin;<br>**1.5.** Zhvillimi i vazhdueshëm profesional;<br>**1.6.** Përgjegjësi ndaj detyrave dhe obligimeve në punë. | **Standardi performanse**<br>1. Standardi vrednovanja performanse koji u dotičnom dokumentu razrađuju na kompetencije i indikatore su:<br>**1.1.** Posvećenost prema učenicima i njihovu nastavi<br>**1.2.** Profesionalna znanja;<br>**1.3.** Nastava;<br>**1.4.** Saradnja sa kolegama, roditeljima i zajednicom;<br>**1.5.** Neprekidni profesionalni razvoj;<br>**1.6.** Odgovornost prema zadacima i obavezama na rad. | **Performance standards**<br>1. Standards of performance evaluation which are elaborated into competences and indicators in respective documents are:<br>**1.1.** Commitment to students and their learning;<br>**1.2.** Professional knowledge;<br>**1.3.** Teaching;<br>**1.4.** Cooperation with colleagues, parents and community;<br>**1.5.** Continued professional development;<br>**1.6.** Responsibility to tasks and obligation at work. |
| **Neni 4**<br>**Bartësit e procesit të vlerësimit**<br>1. Në procesin e vlerësimit të performancës do të marrin pjesë:<br>**1.1.** Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) përmes Departamentit të Inspekcionit;<br>**1.2.** Drejtori i shkollës;<br>**1.3.** Mësimdhënësi;<br>**1.4.** Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) duke mbështetur drejtorët e shkollës dhe duke siguruar transparencë në vlerësimin që bëjnë | **Član 4**<br>**Nosioci procesa vrednovanja**<br>1. U procesu vrednovanja učestvovaće:<br>**1.1.** Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije (MONT) pomoću Departamenta inspekcije<br>**1.2.** Direktor škole<br>**1.3.** Nastavnik<br>**1.4.** Opštinska direkcija za obrazovanje (ODO) podržavajući školske direktore i obezbeđujući transparentnost vrednovanja koju vrše direktori. | **Article 4**<br>**Bearers of evaluation process**<br>1. The following will participate in performance evaluation process:<br>**1.1.** Ministry of Education, Science and Technology (MEST) through the Department of Inspection<br>**1.2.** School director<br>**1.3.** Teacher<br>**1.4.** Municipal Education Directorate (MED) by supporting school directors and by ensuring transparency to evaluation completed by directors. |

| | | |
|---|---|---|
| drejtorët.<br><br>**Neni 5**<br>**Instrumentet e vlerësimit të performancës**<br><br>**1.** Vlerësimi i performancës realizohet përmes katër instrumenteve:<br>**1.1.** Vetëvlerësimi i mësimdhënësit 10% 12 pikë;<br>**1.2.** Vlerësimi i drejtorit të shkollës 30% 36 pikë;<br>**1.3.** Inspektimi/hospitimi në klasë 30% 36 pikë;<br>**1.4.** Planifikimi dhe realizimi i tërësisë mësimore 30% 36 pikë<br>100% deri në 120 pikë.<br><br>**Neni 6**<br>**Roli i MASHT-it**<br><br>**1.** MASHT, përmes Departamentit të Inspekcionit, ka përgjegjësitë në vijim:<br><br>**1.1.** Sigurohet që vlerësimi i performancës në të gjitha aspektet e tij të jetë bërë në përputhje me ligjin;<br>**1.2.** Mbledh të dhëna nga të gjithë komponentët e sistemit të vlerësimit të performancës (përmes instrumenteve të elaboruara në këtë UA) dhe e përcakton nivelin e performancës; | **Član 5**<br>**Instrumenti za vrednovanja performanse**<br><br>**1.** Vrednovanje performanse se obavlja pomoću četiri instrumenata:<br>**1.1.** Samo vrednovanje nastavnika 10% 12 poena;<br>**1.2** Vrednovanje direktora kole 30% 36 poena;<br>**1.3.** Inspekcija/poseta u razred 30% poena;<br>**1.4.** Planiranje i realizacija nastavne celovitosti 30% 36 poena<br>100% 120 poena.<br><br>**Član 6**<br>**Uloga MONT-a**<br><br>**1.** MONT, preko Departmana za inspekciju, ima odgovornosti kao u nastavku:<br>**1.1.** Obezbeđuje da vrednovanje performanse u svim aspektima bude u skladu sa zakonom.<br>**1.2.** Prikuplja podatke iz svih komponenta sistema vrednovanja performanse (pomoću razrađenih instrumenata u ovoj AU) i određuje nivo performanse. | **Article 5**<br>**Performance evaluation instruments**<br><br>**1.** Performance evaluation is completed through four instruments:<br>**1.1.** Teacher self-assessment<br>10% 12 points<br>**1.2.** Evaluation of school director<br>30% 36 points<br>**1.3.** Classroom inspection/observation<br>30% 36 points<br>**1.4.** Whole lesson planning and implementation 30%36 points 100% up to 120 points<br><br>**Article 6**<br>**MEST's role**<br><br>**1.** MEST, through the Department of Inspection, has the following responsibilities:<br>**1.1.** Assures that performance evaluation in all aspects is completed in compliance with the law.<br>**1.2.** Collects data from all components of performance evaluation system (through instruments elaborated in this AI) and determines level of performance. |

| | | |
|---|---|---|
| **1.3.** Mbikëqyr aspektet teknike dhe profesionale të procesit, si përpilimin e orarit të vlerësimit, realizimin e monitorimit në orën e mësimit dhe bën vlerësimin e planifikimit dhe zbatimit të një tërësie mësimore;<br>**1.4.** Bën licencimin e mësimdhënësve në bazë të rezultatit të përgjithshëm të vlerësimit të performancës. | **1.3.** Nadgleda tehničke i profesionalne aspekte procesa, kao sastavljanje rasporeda za vrednovanje i realizuje monitoring nastave, vrši vrednovanje planiranja i primenjivanje celovite nastave.<br>**1.4.** Vrši licenciranje na osnovu opšte rezultate vrednovanja performanse. | **1.3.** Supervises technical and professional aspects of the process, such as compilation of assessment schedule and conducts monitoring of classes, and completes evaluation of planning and implementation of an entire lesson unit.<br>**1.4.** Makes licensing of teachers based on the overall result of performance evaluation. |
| **Neni 7**<br>**Roli i mësimdhënësit** | **Član 7**<br>**Uloga nastavnika** | **Article 7**<br>**Teacher's role** |
| **1.** Mësimdhënësit ofrojnë kontributin e tyre në proces përmes raportit të vetëvlerësimit dhe përgatitjes së formularit të planifikimit dhe të realizimit të tërësisë mësimore, të cilat i ofrohen nga MASHT.<br>**2.** Mësimdhënësi harton planin e zhvillimit personal profesional sipas rezultateve të vlerësimit të performancës. Ky plan hartohet në bashkëpunim me drejtorin e shkollës. | **1.** Nastavnici daju svoj doprinos u nastavnom procesu pomoću izveštaja o samo-vrednovanja i pripremi formulara planiranja i ostvarivanje celovitosti nastave, koja se nudi od strane MONT-a.<br>**2.** Nastavnik sastavlja lični plan profesionalnog razvoja prema rezultatima vrednovanja performanse. Ovaj plan se sastavlja u saradnji sa direktorom škole. | **1.** Teachers provide their contribution to the process through self-assessment report and preparation of the form on planning and implementation of an entire lesson unit, which are provided by MEST.<br>**2.** Teacher drafts a personal professional development plan based on performance evaluation results. The plan is developed in cooperation with the school director. |
| **Neni 8**<br>**Roli i drejtorit të shkollës** | **Član 8**<br>**Uloga direktora škole** | **Article 8**<br>**School director's role** |
| **1.** Drejtori i shkollës e analizon raportin vetëvlerësues të mësimdhënësit dhe e interviston mësimdhënësin para se ta plotësojë formularin e vlerësimit të drejtorit të shkollës. | **1.** Direktor škole analizira izveštaj samo-vrednovanje nastavnika i obavlja intervju sa nastavnikom pre popunjavanje formulara o vrednovanju direktora škole. | **1.** School director analyses teacher's self-assessment report and interviews teacher before he/she fills out school director's evaluation form. |

| | | |
|---|---|---|
| **2.** Në vlerësimin e vet drejtori merr parasysh punën e gjithëmbarshme të mësimdhënësit duke përfshirë edhe vëzhgimet e rregullta që bën në orë mësimore.<br>**3.** Drejtori i shkollës bashkëpunon ngushtë me Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe në rastet e veçanta kur është nevoja kërkon praninë e përfaqësuesit të DKA-së në bisedë me mësimdhënësin që është duke u vlerësuar.<br><br>**Neni 9**<br>**Procedurat e vlerësimit të performancës**<br><br>**1.** Inspektorët përmes DKA-së japin datat e aktiviteteve të planifikuara të inspektimit në shkollat përkatëse.<br>**2.** Mësimdhënësve u jepet formulari për vetëvlerësim të cilin pritet që ta plotësojnë brenda tri ditësh.<br>**3.** Ata pritet që ta plotësojnë formularin e tyre dhe të takohen me mësimdhënës për t'i diskutuar rezultatet brenda 7 ditësh.<br>**4.** Mësimdhënësi dhe drejtori i shkollës i nënshkruajnë formularët e tyre, pastaj drejtori i shkollës i mbledh formularët e vetëvlerësimit dhe ia kthen të nënshkruar në origjinal inspektorit përgjegjës, jo më vonë se tri ditë pas intervistës me mësimdhënës.<br>**5.** Një kopje e formularit të nënshkruar | **2.** U svom vrednovanju direktor uzima u obzir celokupni rad nastavnika obuhvatajući i redovne posete koje vrši na nastavi.<br><br>**3.** Direktor škole usko sarađuje sa Opštinskom direktorijatom za obrazovanje i u posebnim prilikama kada je potrebno traži prisutnost predstavnika ODO-a u razgovoru sa nastavnicima kojima vrši vrednovanje.<br><br>**Član 9**<br>**Procedure vrednovanja performanse**<br><br>**1.** Inspektori preko ODO-a određuju datume planiranih aktivnosti inspekcije u dotične škole.<br>**2.** Nastavnicima se daje formular za samo-vrednovanje; od njih se očekuje da popune obrazac u roku od tri dana.<br>**3.** Oni ispunjavaju njihov obrazac i sastanu sa nastavnicima da bi raspravili o rezultatima u roku od 7 dana.<br>**4.** Nastavnik i direktor škole potpisuju njihove obrasce, posle direktor škole sakupi obrasce za samovrednovanje i potpisane vrača ovlaščenog inspektora, ne kasnije od tri dana nakon intervjua sa nastavnicima.<br><br>**5.** Jedan primerak potpisanog obrasca | **2.** In its evaluation, the Director considers overall work of the teacher, including regular classroom observations during classes.<br><br>**3.** School director closely collaborates with Municipal Education Directorate and in special cases when it is necessary he/she asks for presence of MED representative in the conference with teacher that is being evaluated.<br><br>**Article 9**<br>**Performance evaluation procedures**<br><br>**1.** Through MEDs, inspectors provide dates of planned inspection activities in respective schools.<br>**2.** Teachers are given self-assessment form; they are expected to fill out the form within three days.<br>**3.** They are expected to fill out their form and meet with the teachers to discuss results within 7 days.<br>**4.** Teacher and the school principal sign their forms, while school principal collects self-assessment forms and returns the signed original to the inspector in charge not later than three days after the interview with the teacher.<br><br>**5.** A copy of signed form is remains in teacher's dossier and one copy is given to |

| | | |
|---|---|---|
| mbetet në dosjen e mësimdhënësit dhe një kopje i jepet DKA-së. | ostaje u dosije nastavnika a jedna kopija se daje ODO-a. | MED. |
| **6.** Inspektorët ua japin mësimdhënësve formularin e planifikimit dhe zbatimit të tërësisë mësimore dhe e caktojnë një orë për hospitim në klasë. Mësimdhënësit i kanë 30 ditë për ta plotësuar formularin në fjalë. | **6.** Inspektori dostavljaju nastavnicima formular planiranja i primene nastavne celovitosti i određuju čas posete u razred. Nastavnici maju 30 dana da popune obazac o kojemu je reč. | **6.** Inspectors give to teachers the form for planning and implementation of an entire lesson unit and he/she assigns a class for classroom observation. Teachers have 30 days to fill out the given form. |
| **7.** Ora e mësimit të cilën e hospiton inspektori duhet të jetë në kuadër të njësisë të cilën e përshkruan mësimdhënësi në formularin e planifikimit dhe zbatimit të tërësisë mësimore. | 7. Nastavni čas na kojemu će bit obavljena poseta treba biti u okviru jedinice koju opisuje nastavnik u formular planiranja i primene celovitosti nastave. | **7.** The class which is observed by the inspector must be part of the unit which the teacher describes in the form for planning and implementation of an entire lesson unit. |
| **8.** Inspektori bën hospitimin në klasë duke e përdorur protokollin e vëzhgimit. Ai e vlerëson përmes pikëve orën mësimore të cilën e ka vëzhguar dhe ia jep mësimdhënësit një kopje të nënshkruar të raportit brenda 7 ditësh. | **8.** Inspektor obavlja posetu u razred koristeći protokol o nadgledanju. On vrednuje pomoću poena nastavni čas na koji je obavio nadzor i daje nastavniku potpisanu kopiju izveštaja u roku od 7 dana. | **8.** The inspector completes classroom observation by using observation protocol. He/she assesses the lesson he/she observed by points and gives a signed copy of the report to the teacher within 7 days. |
| **9.** Mësimdhënësi ia dërgon inspektorit formularin e nënshkruar të planifikimit dhe zbatimit të njësisë mësimore brenda një afati kohor prej 30 ditësh. Inspektori e vlerëson me pikë këtë formular dhe ia kthen raportin mësimdhënësit brenda 7 ditësh. | **9.** Nastavnik dostavlja inspektoru potpisani formular za planiranje i primenu nastavne jedinice u određeni vremenski period od 30 dana. Inspektor vrednuje poenima ovaj formular, vrača izveštaj nastavniku u roku od 7 dana. | **9.** The teacher sends to the inspector the signed form for planning and implementing an entire lesson unit within a timeframe of 5 weeks. The inspector assesses the form with points and returns the report to the teacher within 7 days. |
| **10.** MASHT përmes departamentit të inspekcionit ruan të dhënat e të gjitha pjesëve të vlerësimit, në mënyrë që të nxirren analiza të ndryshme, ndërsa rezultati final i vlerësimit do të vendoset në programin e caktuar për licencimin e | **10.** MONT putem departamenta za inspekciju čuva sve podatke za sve delove vrednovanja kako bi izvukli različite analize, dok konačni rezultat vrednovanja ubaci će se u određeni program za licenciranje nastavnika. | **10.** MEST, through the Department of Inspection, saves data of all parts of evaluation in order to do various analyses, while the final evaluation result will be entered into the specified software for teacher licensing. |

| | | |
|---|---|---|
| mësimdhënësve.<br><br>**Neni 10**<br>**Niveli i performancës**<br><br>**1.** Niveli i performancës së mësimdhënësve kategorizohet si më poshtë:<br>**1.1.** Performancë e shkëlqyeshme: performancë që i tejkalon pritjet e përcaktuara nga standardet dhe kompetencat e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve 110 pikë ose më shumë;<br>**1.2.** Performancë e mirë: performancë që i përmbush pritjet e përcaktuara nga standardet dhe kompetencat e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve 90 pikë ose më shumë;<br>**1.3.** Performancë e kënaqshme: performancë që në masë të madhe i përmbush pritjet e përcaktuara nga standardet dhe kompetencat e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve 70 pikë ose më shumë;<br>**1.4.** Performancë jo e kënaqshme: performancë që nuk i përmbush pritjet e përcaktuara nga standardet dhe kompetencat e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve më pak se 70 pikë. | **Član 10**<br>**Nivo performanse**<br><br>**1.** Novo performanse nastavnika se kategorizuje ko u nastavku:<br><br>**1.1.** Odlična performansa: performansa koja prevazilazi određena očekivanja standarda i kompetencija vrednovanja nastavnike 110 poena ili više;<br><br>**1.2.** Dobra performansa: performansa koja ispunjava određena očekivanja iz standarde i kompetencije vrednovanja performanse nastavnika 90 ili više poena;<br>**1.3.** Zadovoljavajuća performansa što u velikoj meri ispunjava određena očekivanja standarde i kompetencije vrednovanje performanse nastavnika 70 ili više poena;<br><br>**1.4.** Ne zadovoljavajuća performansa koja ne ispunjava određena očekivanja standarda i kompetencije vrednovanja performanse nastavnika manje od 70 poena. | **Article 10**<br>**Performance level**<br><br>**1.** Teachers' performance level is categorized as follows:<br><br>**1.1.** Excellent performance: performance that exceeds expectations defined by standards and competences of teacher performance evaluation (110 points or more)<br><br>**1.2.** Good performance: performance that meets expectations defined by standards and competences of teacher performance evaluation (90 points or more)<br>**1.3.** Satisfactory performance: performance that to a large extent meets expectations defined by standards and competences of teacher performance evaluation (70 points or more)<br>**1.4.** Unsatisfactory performance: performance that does not meet expectations defined by standards and competences of teacher performance evaluation less than 70 points |

| Neni 11<br>Implementimi | Član 11<br>Implementacija | Article 11<br>Implementation |
|---|---|---|
| **1.** MASHT elaboron në detaje standardet, kompetencat dhe indikatorët; instrumentet; procedurat si dhe rrjedhën e vlerësimit të performancës në Manualin e Vlerësimit të Performancës së Mësimdhënësve, i cili i ofrohet secilës shkollë në formë të shtypur. | **1.** MONT u detalje elaborira Standarde, Kompetencije i Indikatore; Instrumente procedure kao i tokove vrednovanja performanse u Priručnik vrednovanje performanse nastavnika koji omogućava kvalitet škole u štampanom obliku. | **1.** MEST elaborates in details Standards, Competences and Indicators; instruments; procedures and process of performance evaluation in the Teacher Performance Evaluation Manual, which is provided to every school in printed format. |
| **2.** Mësimdhënësit të cilët nuk arrijnë pikë të mjaftueshme në vlerësimin e performancës që kërkohen për licencim dhe avancim, do t'u jepet mundësia që ta përpilojnë një plan të përmirësimit dhe zhvillimit profesional në bashkëpunim me drejtorin e shkollës. | **2.** Nastavnici koji ne postignu dovoljan broj pena u vrednovanju performanse što je potrebno za licenciranje i unapređivanje biće im data još jedna mogućnost a sastave plan popravke i profesionalni razvoj u saradnji sa direktorom škole. | **2.** Teachers who do not get sufficient points in performance evaluation that are required for licensing and promotion will be given an opportunity to develop an improvement and professional development plan in cooperation with the school director. |
| **3.** DKA-të do t'i analizojnë rezultatet e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve në komunën e tyre dhe hartojnë planin lokal të zhvillimit profesional për nevojat e komunës duke reflektuar edhe elementet e tjera të politikave kombëtare si edhe nevojat e tjera zhvillimore. | **3.** ODO će analizirati rezultate vrednovanja performanse nastavnika u svojoj opštini i sastaviće lokalni plan profesionalnog razvoja za opštinske potrebe reflektujući i druge elemente nacionalne politike kao i druge razvojne potrebe. | **3.** MEDs will analyse results of teacher performance evaluations in their municipality and will develop a local professional development plan for needs of the municipality, which reflects other elements of national policies as well as other development needs. |
| **4.** MASHT siguron lidhjen e ofrimit të zhvillimit profesional me sistemin e vlerësimit të performancës së mësimdhënësve. | **4.** MONT obezbeđuje vezu pružanje profesionalnog razvoja sistema vrednovanje performanse nastavnika. | **4.** MEST ensures linking provision of professional development with teacher performance evaluation system. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 12**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | **Član 12**<br>**Van snažne odredbe** | **Article 12**<br>**Repealing provisions** |
| Me hyrjen në fuqi të këtij UA, shfuqizohen të gjitha udhëzimet dhe dokumentet e tjera që e kanë rregulluar këtë fushë më parë. | Stupanjem na snagu ove AU stavljaju se van snage sve uredbe i ostala dokumenta koja su ranije regulisala ovu oblast. | Upon entry into force of this AI, all other instructions and documents that have regulated this area before are repealed. |
| **Neni 13**<br>**Hyrja në fuqi** | **Član 13**<br>**Stupanje na snagu** | **Article 13**<br>**Entry into force** |
| Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga ministri. | Ova Administrativna uredba stupa na snagu na dan potpisivanje od strane Ministra | This administrative Instruction enters into force on the day of its signature by the Minister. |
| **Prof. dr. Ramë Buja, ministër** | **Prof. dr. Ramë Buja, ministar** | **Prof. dr. Ramë Buja, ministër** |